



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **BOE - “EPES Group” sh.p.k. me NIPT L22320017F**

Adresa: Rruga “Artan Lenja”, zona kadastrale 8220, Nr. pasurie 1/417, Tiranë.

- “A3 B” sh.p.k. me NIPT 810155243

Adresa: “Lidhja e Pejës” 86, Prishtinë, Kosovë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” me mjete elektronike – Punë

Numri i procedurës: REF-37859-08-04-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i shtyllave metalike të linjave të tensionit të lart 220 kV dhe 400 kV”

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Data 08.08.2022, Numri 108.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “SHPRESA – AL” sh.p.k. me NIPT K31321021N

Vlera 99,303,790 (nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.

2. BOE “EPES Group” sh.p.k. me NIPT L22320017F
“A3 B” sh.p.k. me NIPT 810155243

Vlera 108,860,517 (njëqind e tetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “SHPRESA – AL” sh.p.k., me NIPT K31321021N, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur kriterin 1/b, të Shtojcës 7, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas kërkesës së nenit 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe sipas përcaktimit të pikës 3.1 të Njoftimit të Kontratës, në Dokumentet e Tenderit.
- Nuk ka përmbushur Shtojcën 2 të Dokumenteve të Tenderit “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, për arsye se nuk ka plotësuar tabelën e paraqitur në këtë Shtojcë, duke mos plotësuar në mënyrë të saktë çmimet për njësi të ofertuara.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme, sipas përcaktimeve të këtij kriteri në Dokumentet e Tenderit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mallrave të kërkuara, si dhe katalog/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit për listën e materialeve të mallrave të kërkuara.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi objekti i certifikimeve ISO të OE ofertues nuk është i lidhur me objektin e procedurës së prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “EPES Group” sh.p.k., me NIPT L22320017F**, Adresa: Rruga “Artan Lenja”, zona kadastrale 8220, Nr. pasurie 1/417, Tiranë & **“A3 B” sh.p.k., me NIPT 810155243**, Adresa: “Lidhja e Pejës” 86, Prishtinë, Kosovë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **108,860,517 (njëqind e tetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova